



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1125 Prot.
2

Gramsh, më 08.04. 2022

V E N D I M

Nr. 36, datë, 31/03/ 2022

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QË DO TË MERREN
PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2022.

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 31. 03.2022, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor mbështetur në KPA në Republikën e Shqipërisë: në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin nr. 107/2014 datë 03.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” i ndryshuar, në V.K.M nr.684, datë 02.09.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, VKM nr.288, datë 27.06.2002, “Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundra zjarrit dhe shpëtimin në objekteve me rëndësi ekonomike dhe shtetërore”, VKM nr.290, datë 30.04.2004, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe menaxhimin e zjarreve në pyje e kullota”, me shtresat dhe ndryshimet, VKM nr.1080, datë 22.12.2010, “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njëjësive vullnetare të shuarjes së zjarreve, Këshilli Bashkiak.

V E N D O S I :

1. Të miratojë “Plan – Pune”, Për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, për vitin 2022, hartuar nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, pranë bashkisë Gramsh.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit, si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky “Plan – Pune”, për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2022, hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konc.Xh.Gjini
Konf.G.Lena
Dosja:

Kryetar i Këshillit të Bashkisë

GRETA LENA

